

Fjalimi i Guvernatorit me rastin e shënimit të 15 vjetorit të BQK-së

Të nderuar ...

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë t'ju dëshiroj mirëseardhje në shënimin e 15 vjetorit të themelimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Ngjarjet e tilla, përveç që shërbejnë për t'i rikujtuar fillimet se ku kemi qenë, paraqesin një mundësi shumë të mirë për t'i parë arritjet dhe progresin që është bërë gjatë kësaj periudhe dhe, mbi këtë bazë, të përgatitemi dhe të jemi të gatshëm për sfidat që na presin në të ardhmen.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, fillimisht e njohur si Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës dhe pastaj si Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës, u themelua 15 vite më parë, në kohën kur zhvillimi institucional i Kosovës vetëm sa kishte filluar, përderisa situata e pasluftës paraqiste kërkesa të mëdha.

Në të kaluarën, në rrethana të tjera dhe në kuadër të një rendi tjetër shoqëror, Kosova kishte pasur sistem e vet financiar, i cili qe shkatërruar tërësisht gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar. Prandaj, duke mos trashëguar pothuajse asgjë nga e kaluara, që në ditët e para të veprimtarisë së saj, krahas angazhimeve të

mëdha për organizimin e saj të brendshëm dhe zhvillimin e resurseve të saj, me ç'rast gjithçka po niste nga e para, BQK-ja filloi të angazhohej për ndërtimin e infrastrukturës financiare, duke përfshirë ndërtimin e sistemit të pagesave, formulimin e kornizës rregullatore për sektorin financiar, si dhe zhvillimin e funksioneve tjera të nevojshme për zhvillimin e sektorit financiar.

Fillimi i funksionimit të BQK-së ndodhi në kohën kur pjesa më e madhe e vendeve të rajonit ishin drejtë përfundimit të procesit të tranzicionit, me ç'rast lëshimet e bëra në fillim të këtij procesi, ndikuan që tranzicioni të jetë i gjatë dhe i vështirë. Këto vështirësi qenë reflektuar edhe në zhvillimin e sistemit financiar dhe bankar të vendeve në tranzicion. BQK-ja u tregua e vëmendshme të mësojë nga vështirësitë nëpër të cilat kaluan bankat qendrore të rajonit dhe zgjodhi modelin, i cili u tregua i suksesshëm për zhvillimin e një sektori financiar efikas dhe të qëndrueshëm. Në këtë mënyrë, BQK-ja vendosi bazat e një sistemi financiar të bazuar në pronësi private dhe, që nga fillimi, hapi dyert për hyrjen e institucioneve të huaja financiare. Në fakt, ishin institucionet e huaja financiare, veçanërisht bankat, të parat që filluan aktivitetin e tyre në Kosovë, duke sjellë përvojat bashkëkohore të industrisë financiare dhe duke rikthyer besimin e publikut vendor në sistemin financiar.

Po ashtu, BQK-ja në vazhdimësi ka ndjekur një politikë të shëndoshë të licencimit, e cila ka shërbyer si bazë e zhvillimit të shëndoshë të sistemit financiar të Kosovës.

Me këtë rast, duke përfituar nga ky përvjetor, një paraqitje retrospektive e përmbledhur e zhvillimit të sistemit financiar në Kosovë, ilustron më së mirë përparimin që është arritur në këtë sektor.

(Thonë se nganjëherë një fotografi flet më shumë se 1000 fjalë, prandaj të gjitha shifrat që do t'i jap në vazhdim janë të përfshira në grafikun përkatës që po shfaqet në monitor.)

Sektori bankar filloi zhvillimin e tij në vitin 2000, me një kapital të bankave komerciale prej 6.2 milion eurosh. Nga fillimet e para deri në ditët e sotme kapitali i bankave komerciale është rritur në mënyrë të vazhdueshme, duke arritur në 230.4 milion më 2010 dhe 316.9 milion më 2014, përkatësisht duke u rritur për 38 përqind në katër vitet e fundit. Njëkohësisht, përderisa asetet e bankave komerciale në vitin 2000 ishin 103.1 milion euro, më 2010 ato arritën në 2 miliardë e 455 milion euro, ndërkaq sot kanë arritur në 2 miliardë e 956 milion euro, duke u rritur për afro 20% në katër vitet e fundit. Sa i përket aktivitetit depozitar dhe kreditor të bankave, është me rendësi të theksohet se në vitin 2000 depozitat në bankat komerciale ishin në nivelin e 93 milion eurosh. Më tej, kemi një trend të vazhdueshëm në rritjen e depozitave në bankat komerciale. Kështu, më 2010 ato kishin arritur në 1 miliardë e 936 milion, ndërkaq sot depozitat në bankat komerciale kanë arritur në 2 miliardë e 500 milion, duke u rritur për 29% në katër vitet e fundit. Kjo rritje e vazhdueshme e depozitave është treguesi më i mirë që

qytetarët e Kosovës e kanë rikthyer besimin e plotë në sistemin bankar të vendit, pas përvojave të këqija që kishin pasur në të kaluarën. Në anën tjetër, rritje të vazhdueshme kanë pasur edhe kreditë e bankave komerciale. Përderisa gjithçka kishte filluar në vitin 2000, me nivelin e kreditimit prej 3.3 milion eurosh, që nga ajo kohë trendi i rritjes së kreditimit ka vazhduar në nivele të larta. Më 2010, shuma e përgjithshme e kredive të bankave komerciale kishte arritur në 1 miliardë e 458 milion euro, ndërkaq më 2014 niveli i kredive ka arritur në 1 miliardë e 839 milion euro, përkatësisht duke u rritur për 26% në katër vitet e fundit.

Sa i përket normave të interesit për kredi, ndonëse mund të thuhet se për një periudhë kanë qenë të larta, aktualisht jemi dëshmitar të një trendi të vazhdueshëm zbritës të tyre. Më 2014, norma mesatare e interesit ka mbërritur në 10.4 përqind, ndërkaq ky fundvit jep tregues të qartë se normat e interesit në kredi tashmë kanë rënë në vlera njëshifrore. Jemi të bindur që, shumë shpejt, këto norma do të jenë në nivelin e rajonit. Për ta arritur këtë qëllim, jemi duke punuar ngushtë me të gjitha palët me interes, që t'i mënjanojmë të gjithë faktorët potencialë, të cilët mund të kenë ndikim negativ në nivelin e kamatave dhe jemi të bindur që brenda një periudhe të shkurtër kohore, do të përmbushen të gjitha parakushtet, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në rënien e mëtejme të normave të interesit në kredi. Parasëgjithash, kërkohet një përmirësim i mëtutjeshëm i efikasitetit operativ të bankave dhe ambientit të përgjithshëm afarist në vend. Në këtë aspekt, dëshiroj t'i

vë theks të veçantë nevojës për rritje të efikasitetit të gjyqësorit, për sa i përket shqyrtimit të lëndëve bankare. Rënia e mëtejme e normave të interesit është synimi ynë parësor, pasi që konsiderojmë që sektori financiar duhet të jetë në funksion të mbështetjes së drejtpërdrejtë të sektorit real, sepse konsiderojmë se zhvillimi dhe rritja e sektorit financiar dhe e sektorit real duhet të jenë komplementarë me njëri-tjetrin. Këtu, vetëm të përmendim se edhe interesat në depozita, ndonëse në të kaluarën kanë qenë në nivele relativisht të larta, kohëve të fundit ato kanë pasur një rënie, që është një tregues i likuiditetit të mjaftueshëm në sektorin bankar. Në përgjithësi, sektori bankar, si komponenti kryesor i sistemit financiar të Kosovës, ka vazhduar të zgjerojë aktivitetin kredidhënës në ekonominë vendore, duke shërbyer si burim i qëndrueshëm financimi. Depozitat e mbledhura brenda vendit, vazhdojnë të jenë burimi më i rëndësishëm i financimit për bankat dhe rritja e tyre e qëndrueshme ka bërë që aktiviteti kreditues i bankave të ketë nivel të ulët të ndjeshmërisë ndaj ndryshimit të kushteve të financimit në tregjet e jashtme. Sjellja e kujdesshme e bankave, së bashku me rregullimin dhe mbikëqyrjen e afërt nga BQK-ja, si dhe stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik në vend, ka bërë që sistemi bankar i Kosovës të ketë nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë kundrejt të gjitha aspekteve të rreziqeve bankare. Prandaj, sot mund të flasim për një sektor bankar me rritje të qëndrueshme të kredive dhe të

depozitave, nivel të lartë të kapitalizimit dhe pozitë të fortë të likuiditetit, si dhe me cilësi të mirë të portofolit kreditor.

Progres i ngjashëm është shënuar edhe në komponentët tjerë të sistemit financiar të Kosovës. Sektori i sigurimeve është rritur në vazhdimësi dhe ka treguar aftësi të kënaqshme për t'i mbuluar obligimet ndaj mbajtësve të policave të sigurimit. Megjithatë, konsiderojmë se ka mjaft hapësirë për zhvillim të mëtutjeshëm të këtij sektori, duke e rritur gamën e shërbimeve dhe duke bërë shërbimet e sigurimit të kenë një shkallë më të lartë të depërtimit në ekonominë e vendit.

Performancë të kënaqshme ka treguar edhe sektori i pensioneve, në të cilin vlera e kontributeve po vazhdon të rritet, ndërsa performanca e mirë e investimeve po sjellë shtim të vlerës së kursimeve pensionale.

Për sa i përket institucioneve mikrofinanciare, ato kanë vazhduar të përfaqësojnë një burim alternativ të financimit kreditor në ekonominë e Kosovës, sidomos për klientët më të vegjël, siç janë ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet e vogla.

Në përgjithësi, aktualisht në Kosovë kemi 10 banka, të cilat janë të licencuara nga BQK-ja dhe nga këto dhjetë banka, 8 janë banka me kapital të huaj dhe dy janë me kapital vendor. Në fushën e sigurimeve, kemi 14 kompani, të cilat janë të licencuara nga BQK-ja, prej të cilave 9 janë kompani me kapital të huaj dhe 5 janë me kapital vendor. Po ashtu, në tregun financiar veprojnë 2 fonde pensionale,

si dhe një numër i institucioneve që ushtrojnë veprimtari mikrofinanciare dhe veprimtari financiare jobankare, të cilat e plotësojnë larminë e shërbimeve financiare për qytetarët e Kosovës. Prania e një numri kaq të madh të kompanive me kapital të huaj, është një tregues që sektori financiar ka pranuar në masë të konsiderueshme investime të huaja të drejtpërdrejta, të cilat janë një tregues domethënës se investitorët e huaj kanë qenë dhe mbasin të gatshëm të investojnë në tregun e Kosovës, duke e konsideruar atë me leverdi ekonomike.

Puna jonë e deritanishme, mbi të gjitha, është kurorëzuar me një sistem financiar të shëndoshë, i cili me ritmin e tij të shpejtë të zhvillimit, është bërë njëri ndër promotorët kryesor të zhvillimit dhe stabilitetit të ekonomisë së Kosovës. Kontributi i stabilitetit të sistemit financiar të Kosovës në stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik në vend, u vërejt qartë sidomos gjatë krizës së fundit financiare globale. Për dallim nga shumë vende, në të cilat institucionet financiare u bënë barrë e rëndë për financat publike, sistemi financiar i Kosovës u tregua i qëndrueshëm dhe madje arriti të zbusë edhe efektet e sektorëve të tjerë të ekonomisë, të cilët ishin më të prekur nga kriza.

Sot, pas 15 viteve, të arriturat e institucionit tonë konsideroj se janë domethënëse dhe, për këtë, në radhë të parë, dëshiroj të shprehë mirënjohjen time për të gjithë punonjësit e BQK-së, të cilët me një entuziazëm dhe përkushtim të lartë kanë arritur ta shndërrojnë BQK-në në një institucion modern, të aftë për t'i shërbyer

prosperitetit dhe stabilitetit ekonomik të vendit. Gjatë kësaj periudhe, BQK-ja ka shënuar progres në të gjitha shtyllat e aktivitetit të saj, duke arritur të ndërtojë një sistem modern të pagesave dhe duke ofruar shërbime efikase të furnizimit me para të gatshme për ekonominë. Aktualisht, BQK-ja ka një kornizë rregullatore financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kapacitete të avancuara mbikëqyrëse, statistika cilësore dhe analiza ekonomike e financiare, të cilat i ofrojnë autoriteteve vendimmarrëse dhe publikut një kuptim të drejtë të zhvillimeve në ekonominë e vendit, si dhe në vazhdimësi ka treguar efikasitet të lartë në ofrimin e shërbimeve bankare për Qeverinë.

Me një përkushtim të veçantë, më lejoni të theksoj se këto të arritura, nuk do të kishin qenë të mundura po të mos ishte ndihma gjithëpërfshirëse dhe e pakursyer e miqve tanë ndërkombëtar, të cilët me përvojën e tyre dhe dëshirën e madhe për të ndihmuar, bënë që rruga jonë të jetë më e shpejtë dhe më pak e mundimshme. Me këtë rast, dëshiroj të shprehë mirënjohje të veçantë për institucionet ndërkombëtare, siç janë: Departamentin e Thesarit të ShBA-ve, USAID-i, Komisioni Europian, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Banka Qendrore Evropiane, GIZ-i dhe shumë institucione tjera, që kanë dhënë dhe po vazhdojnë të japin kontribut të çmuar për zhvillimin e institucionit tonë. Me taksat e qytetarëve të vendeve të tyre, këto institucione kanë dhënë kontribut të drejtpërdrejtë për t'i ndërtuar dhe zhvilluar kapacitetet tona institucionale dhe për

këtë po e shfrytëzoj rastin që nga ky podium të shpreh mirënjohjen tonë të thellë për taksapaguesit e shteteve mike që na ndihmuan në këtë rrugëtim.

Si rrjedhojë e punës së saj, BQK-ja ka arritur në një nivel të krahasueshëm me rajonin dhe vazhdon të jetë njëri ndër institucionet më të vlerësuara në vend, gjë e cila vërehet qartë edhe nga raportet ndërkombëtare, midis të cilave mund të veçojmë Raportin e Progresit të Komisionit Evropian, i cili shënon të arriturat e pamohueshme dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar në Kosovë. Po ashtu, puna e BQK-së në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës financiare dhe zhvillimin e sektorit financiar në përgjithësi, është reflektuar edhe në raportin e Bankës Botërore për “Të bërit biznes për vitin 2015”, në të cilin treguesi për “marrje të kredisë” e radhit Kosovën në vendin 23-të në rangim global, që paraqet një nivel shumë të kënaqshëm.

E gjithë kjo që prezantova deri më tani, konsideroj se paraqet një bazë të mirë për të konstatuar se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka kaluar pesëmbëdhjetë vite të suksesshme, gjatë së cilave ka arritur të shndërrohet në një institucion modern dhe të zhvillojë një sistem financiar të aftë për t’i ndihmuar prosperitetit dhe stabilitetit të ekonomisë së vendit.

Megjithatë, jemi të vetëdijshtëm se dinamika me të cilën po zhvillohet industria financiare në rrafshin global paraqet sfida të reja për bankat qendrore. Prandaj,

jemi të përkushtuar të vazhdojmë të punojmë me ritme të larta për zhvillimin e mëtutjeshëm të BQK-së, duke u shërbyer në vazhdimësi objektivave tona që dalin nga Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Në këtë kuadër, kemi hartuar një plan të detajuar strategjik të BQK-së për periudhën 2015-2019. Ky plan strategjik, së bashku me një projekt të sapofilluar me Bankën Qendrore Evropiane për identifikimin e nevojave të BQK-së për arritjen e standardeve të bankave qendrore të Eurozonës, paraqet një shteg të qartë për zhvillimin e mëtejshëm të BQK-së. Gjatë ecjes nëpër këtë shteg, padyshim, do të ballafaqohemi me sfida të ndryshme, mirëpo e kam besimin e plotë se të arriturat e deritanishme, përkushtimi dhe profesionalizmi i lartë i personelit tonë, së bashku me përkrahjen e vazhdueshme të institucioneve vendore e ndërkombëtare, janë indikatorë për vazhdimin e zhvillimit të suksesshëm të BQK-së dhe sistemit financiar të Kosovës në përgjithësi.

Në fund, dëshiroj edhe një herë t'ju falënderoj shumë për kontributin tuaj të vazhdueshëm për zhvillimin tonë, si dhe për pjesëmarrje në shënimin e këtij përvjetori të rëndësishëm

Ju faleminderit!